



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
SHKOLLA PROFESIONALE SHËRBIME KORÇË

Nr 323 prot

Korçë më 20. 09. 2024

**Lënda: Njoftim për Lëvizje Paralele**

**Drejtuar : Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive  
Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore  
Drejtorisë së Marëdhënieve me publikun**

**Tiranë**

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhezimit të Ministrisë e Financave dhe Ekonomisë nr. 14, datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësive të zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", I ndryshuar.

Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla Profesionale Shërbime, Korçë

Ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

Mësimdhënës i Teorisë dhe Praktikes Profesionale me kohë të pjesëshme, 1 mësues, për "Degën Dizanj- Mode" pas të mesme me ngarkesë javore 13 orë mësimor.

**1.Kriteret e përgjithëshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë dhe praktikës profesionale në Shkolla Profesionale Shërbime, Korçë janë:**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithëshme për lëvizjen paralele si vijon:

- q) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- r) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- s) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- t) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- ë) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet të plotësoje Kriteria të posaçme si vijon:

- i) Të ketë diplomë Përkatëse niveli Master profesional ose të barazvlefshem me të , në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së.
- j) Të ketë të paktën 3 (tre) vite eksperiencë pune në fushën, në të cilën është kualifikuar;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

## 2. Dokumentet e aplikimit

5. Dosja e aplikimit , e cila përmban dokumentacionin e kërkuar , sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë :

- a) Letër motivimi për pozicionin;
- b) Jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojces 11 të këtij udhëzimi
- c) Kartën e identitetit,
- d) Diplomën
- e) Librezën e punës
- ë) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në cv;
- f) Çertifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- g) Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- gj) Vërtetim të gjëndjes gjyqësore;
- h) Vërtetim nga punëdhënësi i fundit që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi .
- e) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentat e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës.....01.10.2024

TATIANA MERO  
DREJTORI SHKOLLËS

